



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-80
Prishtinë, më 20 tetor 2009, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 20 TETOR 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Myfera Shinik dhe Slobodan Petroviq, anëtarë të Kryesisë, ndërsa munguan: Xhavit Haliti, Nexhat Daci dhe Ibrahim Gashi.

Kryetarët e grupeve parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Xhezair Murati, kurse munguan: Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Sherif Konjufca, Selman Ymeri dhe Arsim Avdijaj.

Nga NDI-a, Shefki Kastrati.
Nga OSBE-a, Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozim të Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 tetor 2009.
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 tetor 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 tetor 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 29 tetor 2009, me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 e 17 tetor 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Civil,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për financimin e subjekteve politike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimet postare,
9. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend më 30 shtator 2009,
11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi, me mbështetje të deputetëve tjerë, për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës,
13. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me korrigjimin e referencave në Ligjin për gazin natyror, të miratuar në Kuvend më 30 shtator 2009,

Kryesia vendosi që Komisioni FunkSIONAL t'i hartojë propozimet e nevojshme të korrigjimeve në Ligjin për gazin natyrorë dhe t'ia paraqes Kuvendit për miratim në seancë plenare, më 29 tetor 2009.

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi, me mbështetje të deputetëve tjerë, për formimin e Komisionit hetimor për gjendjen në RTK

Kryesia vendosi që kjo pikë të radhitet për seancën plenare më 29 tetor 2009.

3.3 Ftesa e Asamblesë Parlamentare e NATO-s për pjesëmarrjen e delegacionit të Kuvendit në Seancën vjeshtore, në Edinburg të Skotlandës, më 13-17 nëntor 2009

Kryesia shtyri këtë pikë për mbledhjen e ardhshme.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së për kompensimin e punës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, në shumën prej 50 €, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës për pjesëmarrje në mbledhje.

Kryesia lidhur me kërkesën për kompensimin e stafit civil të Administratës së Kuvendit mori këtë

V E N D I M

Stafit mbështetës të Administratës së Kuvendit nuk u takon kompensim shtesë për angazhim në punën e komisioneve ad hoc, sipas nenit 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

3.5 Njoftimi me shqyrtimin e Përfundimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës

Kryesia vendosi që pika e cekur më lart të radhitet për seancën plenare, më 29 tetor 2009.

3.6 Njoftimi me kërkesën e kryetarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës lidhur me emërimet e anëtarëve të këtij këshilli

Kryesia pasi diskutoi për këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga institucionet përkatëse që të bëjnë propozimet e reja të kandidatëve për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, në pajtim me nenin 3.3 dhe 3.5 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës.
2. Propozimet, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi, t'i dërgohen Kuvendit sa më shpejt që të jetë e mundur.

3.7 Njoftimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

3.8 Njoftimi me propozimet e grupeve parlamentare për anëtarët e tri komisioneve të reja parlamentare

Kryesia vendosi që pikat 3.7 dhe 3.8 të radhiten si pikë e përbashkët në seancën plenare, më 29 tetor 2009.

Gjithashtu, Kryesia vendosi që të kërkohej nga grupet e tjera parlamentare, që nuk i kanë bërë propozimet, t'i propozojnë kandidatët për anëtarë të komisioneve parlamentare.

3.9 Njoftimi me kërkesën e drejtorit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të KPMM-së

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekuar më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga Qeveria e Kosovës që të iniciojë procedurën për propozimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

2. Propozimet, sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t'i dërgohen Kuvendit para mbajtjes së seancës plenare të muajit nëntor të këtij viti.

3.10 Shqyrtimi i kërkesës për ridestinimin e mjeteve lidhur me realizimin e projekteve investive

Kryesia shtyri këtë pikë për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë, me kërkesë që të jetë i pranishëm sekretari i Kuvendit për ta arsyetuar atë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale